



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLICA KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pronar - Prinjeno MollDana	30.04.2018		
Nr.i organit Org.broj	Numri/Broj	Shtigjetë Prilog	Vlera Vrednos
01 - 110/05-375			



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Vitina

## RR E G U LL O R E

Për kompetencat, përgjegjësitë dhe punën e Komiteteve të Kuvendit të  
Komunës së Vitisë

Viti, 27.04.2018

Në bazë të nenit 11, 12.2, shkronja c dhe nenit 51 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36 shkronja c, nenit 40 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seance e mbajtur më datën 27.04.2018, miraton këtë:

## RR E G U LL O R E

Për kompetencat, përgjegjësitë dhe punën e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Vitisë

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kompetencat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

#### Përkufizimet

#### Neni 2

Me këtë rregullore përcaktohen disa nga përkufizimet më sa vijon:

“Komitetet” janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, të cilët punojnë për Kuvendin dhe në emër të Kuvendit”.

“Material” paraqet të gjitha dokumentet të cilat i paraqiten komitetit përkatës nga drejtoria, e cila është në vijë të linjës me atë komitet dhe nga institucionet tjera.

#### Qëllimi i themelimit të komiteteve

#### Neni 3

3.1. Komitetet themelohen në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës, me qëllim që të lehtësojnë punën e Kuvendit të Komunës, në lidhje me procesin e marrjes së vendimeve, pasi që Kuvendi nuk është në gjendje që në tërësi dhe në mënyrë adekuatë të merret me numrin e madh të çështjeve që mund të parashtrohen në Komunë. Shumë çështje me të cilat përballet Komuna janë të një natyre teknike, që kërkojnë angazhimin e ekspertëve, të cilët mund të mos jenë anëtarë të Kuvendit, por që shërbejnë si anëtarë të komiteteve përkatëse. Prandaj, komitetet e lehtësojnë punën e Kuvendit, duke e racionalizuar kohën e marrjes së vendimeve, për t'u ofruar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit analiza profesionale, konsultime dhe angazhim për çështjet specifike.

#### Karakteristikat e përbashkëta

#### Neni 4

4.1. Shumica e anëtarëve të komiteteve, do të janë anëtarë të Kuvendit të Komunës. Anëtarësia e seilit komitet do të reflektojë përbërjen e Kuvendit të Komunës, që kanë partitë politike në Kuvendin e Komunës, duke siguruar pjesëmarrje të barabartë gjinore sipas Ligjit për Barazi Gjinore. Emërimi i anëtarëve të disa komiteteve do t'i përgjigjet specifikimit të tyre, siç është rasti me komitetet e përhershme obligative.

#### Komitetet

#### Neni 5

Në pajtim me LVQL-në dhe Statutin e Komunës së Vitisë, janë të themeluara këto komitete:

a. Komitetet e përhershme obligative:

1. Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe
2. Komiteti për Komunitete

b. Komitetet tjera:

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
2. Komiteti për Planifikim Urban, dhe Mbrojtje të Mjedisit;
3. Komiteti për Shërbime Publike;
4. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
5. Komiteti për Barazi Gjinore.

## **Kompetencat dhe përgjegjësitë e komitetave**

### **a) Komiteti për Politikë dhe Financa**

#### **Neni 6**

6.1. Komiteti për Politikë dhe Financa, në pajtim me LVQL-në dhe Statutin e Komunës, është përgjegjës: për shqyrtimin e të gjitha politikave; dokumenteve fiskale dhe financiare; planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet dhe planifikimin strategjik; kornizën vjetore buxhetore afatmesme; planin vjetor të prokurimit; rregulloren vjetore për tatimet; tarifat dhe pagesat; planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm; buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal; si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

6.2. Përpos përgjegjësive të cekura në nenin 6.1 të kësaj rregulloreje, Komiteti për Politikë dhe Financa, ushtron edhe këto përgjegjësi: shqyrton dhe rekomandon ndihma të menjëherëshme, të cilat i kalojnë autorizimet e kryetarit të Komunës dhe për këtë e njofton Kuvendin; shqyrton çështjet themelore ekonomike dhe sociale të komunës, si dhe çështjet me rëndësi të veçantë; jep mbështetje për zhvillimin ekonomik brenda komunës, duke përfshirë strukturimin ekonomik; këshillon Kuvendin në mënyrë të përgjithshme në lidhje me zbatimin e procedurave financiare dhe ekonomike; shqyrton dhe propozon rendin e ditës për mbledhjet e Kuvendit të Komunës; trajton çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet e anëtarëve të Kuvendit dhe mëditjet; shqyrton partneritetet në mes të qyteteve e komunave; ushtron të gjitha funksionet e Kuvendit të Komunës në raste emergjente, të cilat përcaktohen nga kryetari i Komunës, përpos atyre që nuk delegohen; propozon shlyerjen e borxheve; ushtron edhe përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVQL-në dhe me Statut të Komunës.

### **b) Komiteti për Komunitete**

#### **Neni 7**

7.1. Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoritetave komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktivitetave për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës dhe ushtron edhe përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVQL dhe me Statut të Komunës.

## **Komitetet tjera jo të përhershme:**

## **1) Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

### **Neni 8**

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është përgjegjës për fushat që lidhen me kujdesin parësor dhe në kuadër të bashkëpunimit dhe të kujdesit shëndetësor.

1. Përkujdeset për zbatimin e shërbimeve për kujdesin parësor shëndetësor në komunë;
2. Shqyrton propozimet e dreitorit të QKMF-së nëpërmjet DSHMS-së;
3. Shqyrton buxhetin për Sektorin e Shëndetësisë dhe ia dorëzon atë Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit për miratim;
4. Shqyrton dhe jep propozime dhe sugjerime për projekt-planin vjetor të punës, të përgatitur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
5. Shqyrton raportin vjetor, të përgatitur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe mund të propozojë ndryshime ose plotësimë, dhe t'ia dërgojë KPF-së dhe Kuvendit për miratim;
6. Shqyrton dhe propozon programe për mbështetjen komunale, grupeve me gjendje jo të mirë financiare të njerezve (invalidët e luftës, viktimat e dhunës familjare, fëmijët jetim, të pastrehët, të rikthyerit, pensionistët etj), dhe propozon masa përkatëse;
7. Mbështet dreitorinë në ushtrimin e kompetencave dhe detyrate në lidhje me strehimin;
8. Vlerëson propozimet e drejtorisë për strategjitetë dhe planet e strehimit, duke përfshirë ndërtimin e shtëpive, renovimin e tyre si dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre për këto qëllime;
9. Shqyrton programët në raste emergjente, për strehim të refugjatëve, planet dhe zgjidhjet emergjente për fluksin e refugjatëve dhe rikthimin në vendet e tyre dhe
10. Ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVQL-në dhe me Statut të Komunës.

## **2) Komiteti për Planifikim Urban, dhe Mbrojtje të Mjedisit**

### **Neni 9**

Komiteti për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ushtron këto përgjegjësi:

1. shqyrton propozim-vendimin për qasje në hartimin e planeve urbanistike, propozim-vendimet për miratim të projekt - planeve urbanistike dhe atyre për miratim të këtyre llojeve të planeve;
2. shqyrton propozimet e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, për prioritet dhe strategjitet e nxjerrjes, ndryshimit, plotësimit dhe implementimit të planit zhvillimor komunal, urban dhe planeve rregulluese;
3. shqyrton propozim-planin e punës dhe raportin e punës të drejtorisë së linjës, para prezantimit të tij për miratim nga Kuvendi i Komunës;
4. shqyrton dhe inicion propozime për sigurimin e informatave të nevojshme lidhur me zhvillimet e ndërtimeve ilegale dhe marrjen e masave për parandalimin e tyre;
5. inicion dhe propozon masa për mbrojtjen e ambientit, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit, si dhe të zbatimit të ligjit dhe akteve tjera nënligjore nga ky lëmë;
6. shqyrton informatat mbi zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollin e standardeve të ndërtimit, dhe propozon masa për zbatim dhe kontrollin e tyre;
7. përkujdeset dhe propozon masa për ruajtjen e objektit, të shpallura me interes arkitektonik apo historik, dhe
8. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVQL-në dhe me Statut të Komunës.

## **3) Komiteti për Shërbime Publike**

## Neni 10

Komiteti për Shërbime Publike është përgjegjës:

1. këshillon dhe konsultohet me drejtoritë e linjës;
2. shqyrton planet dhe raportet e punës së drejtorive të linjës;
3. përcjell zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit, në lidhje me shfrytëzimin e shërbimeve dhe veprimeve;
4. monitoron dhe vlerëson efikasitetin e metodave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve; cakton burimet në përputhje me rrithanat;
5. shqyrton programet e ofrimit të shërbimeve për ujë dhe projektet për menaxhimin e ujërave të zeza;
6. shqyrton buxhetin e propozuar vjetor për shërbime, parashikimet e fondeve të nevojshme për personel, mallra dhe shërbime dhe investime;
7. shqyrton raportet për Kuvendin e Komunës, për sistemet operative dhe përmirësimet;
8. këshillon dhe konsultohet në lidhje me çështjen e mbledhjes së kuotave në arkëtim në të gjitha ndërmarrjet shërbbyese;
9. shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me transportin publik dhe propozimet strategjike përrugët lokale;
10. shqyrton programet për ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës;
11. shqyrton realizimin e projekteve të infrastrukturës;
12. shqyrton kërkesat e komuniteteve për ndërtimin e infrastrukturës;
13. monitoron realizimin e programeve për parqet, fushat rekreative dhe të argëtimit, shëtitoret publike, hapësirat publike të Komunës etj.
14. propozon masat e veçanta për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, kujdeset për zbatimin dhe përparimin e këtyre masave;
15. shqyrton planet e veçanta dhe i propozon drejtorisë së linjës dhe Kuvendit të Komunës nxjerrjen e planit për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, në mbështetje të vlerësimit të rrezikut nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore në pajtim me udhëzimet e lëshuara nga Ministria; dhe
16. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVQL dhe me Statut të Komunës.

## 4) Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

### Neni 11

Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport është përgjegjës:

1. Ndihmon drejtorinë për hartimin e rregulloreve komunale, në pajtim me ligjet në fuqi për arsim;
2. Shqyrton apelet dhe propozimet e nxënësve në lidhje me cilësinë e mësimit dhe masat disiplinore;
3. Mbështet bashkëpunimin shkollë – shoqëri, në mes të institucioneve arsimore dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private që merren me arsimimin e personave;
4. Ndihmon në planifikimin dhe vlerësimin e nevojave arsimore të Komunës;
5. Shqyrton propozimet dhe iniciacionet lokale arsimore;
6. Propozon programet dhe projektet për autoritetet qendrore dhe drejtoritë që kanë të bëjnë me punën e këtij Kuvendi;
7. Mbështet bashkëpunimin shkollë – prindër, bashkëpunimin në mes të shkollave dhe komunitetit;
8. përfushat që kanë të bëjnë kulturën, rininë dhe sportin;

9. ndihmon drejtorinë e linjës për hartimin e rregulloreve komunale, në pajtim me ligjet në fuqi për kulturë, rini dhe sport;
10. mbështet bashkëpunimin kulturë - shoqëri në mes të institucioneve kulturore dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private që merren me arsimim dhe kulturë;
11. ndihmon në planifikimin dhe vlerësimin e nevojave që lidhen me kulturë, rini dhe sport;
12. shqyrton propozimet dhe iniciacionet lokale kulturore, rinore sportive;
13. propozon programet dhe projektet për autoritetet lokale dhe qendrore që kanë të bëjnë me kulturë, rini dhe sport në Komunë;
14. mbështet kremin e festave shtetërore, lokale dhe ndërkombëtare, të njohura ndërkombëtarisht dhe propozon masat e nevojshme për realizimin e programeve kulturore, rinore dhe sportive;
15. shqyrton programet dhe projektet të cilat subvencionohen nga Komuna dhe propozon mbështetjen e tyre eventuale;
16. përcjell zhvillimet ndërkombëtare që bëhen në lëmin e kulturës, rinisë sportit që janë me interes për komunën;
17. përkujdeset që trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit t'i kushtohet rëndësi e veçantë;
18. shqyrton priorititetet e programeve komunale në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit;
19. shqyrton programet komunale për investime kapitale kulturë, rini dhe sport në mënyrë që t'u ofrojë institucioneve kushtet e nevojshme;
20. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVQL-në dhe me Statut të Komunës.

## **5) Komiteti për Barazi Gjinore**

### **Neni 12**

Komiteti për Barazi Gjinore është përgjegjës:

1. përfushën e barazisë gjinore në Komunë dhe avancimin e saj;
2. propozon programet dhe projektet për autoritetet lokale që kanë të bëjnë me barazi gjinore;
3. shqyrton programet dhe projektet në fushën e barazisë gjinore të cilat subvencionohen nga Komuna dhe propozon mbështetjen e tyre eventuale;
4. shqyrton priorititetet e programeve komunale në sferën e barazisë gjinore në Komunë;
5. këshillon dhe konsultohet me Zyrtaren për Barazi Gjinore dhe Kryetarin e Komunës në hartimin e politikave të reja publike në sferën e barazisë gjinore;
6. ushtron përgjegjësi tjera nëse ndryshe nuk është rregulluar me LVQL-në dhe me Statut të Komunës.

### **Neni 13**

Komititetet përkatëse, sipas nenit 5 pika b, përpos kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara me këtë rregullore, mund të shqyrtojnë edhe kategoritë e subvencioneve nga linja e drejtorive përkatëse.

### **Neni 14**

Kompensimi i anëtarëve të komiteteve përkatëse, do të votohet në Kuvend dhe do të bëhet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës, në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

## **Puna e Komiteteve**

### **Mbledhjet dhe rendi në mbledhje**

### **Neni 15**

15.1. Në parim, mbledhjet e komiteteve obligative mbahen njëherë (1) herë në muaj dhe sipas nevojës edhe më shumë. Mbledhjet e komiteteve kryesohen nga Kryesuesit, kurse në mungesë të tyre nga zëvendës kryesuesit.

15.2. Në rast të mungesës së drejtorit në mbledhje të komitetit përkatës, duhet ta caktoi përfaqësuesin e vet të autorizuar, për pjesëmarrije vetëm në atë mbledhje të komitetit përkatës.

15.3 Zyrtarët dhe personat tjerë që nuk janë anëtarë të komiteteve, por që janë të pranishëm në mbledhje, do të lejohen nga ana e kryesuesit të flasin dhe t'i paraqesin qëndrimet dhe propozimet e tyre.

15.4. Kryesuesi i komitetit përkatës mund ta urdhërojë një anëtar ose zyrtar tjetër i cili sipas mendimit të tij bënë veprime që prishin rendin gjatë mbledhjes së komitetit dhe që janë në kundërshtim me kodin e sjelljes që t'i përbahet rregullave të punës në komitet. Në rast se anëtarë ose zyrtari tjetër edhe pas urdhrit që t'i përbahet rregullave të punës në komitet, vazhdon t'i shkelë rregullat e punës së komitetit, kryesuesi mund ta urdhërojë që ta lëshojë mbledhjen e komitetit vetëm për atë takim.

#### Neni 16

Shqyrtimi i ndonjë akti të përgjithshëm juridik ose ndonjë propozim tjetër përbajtjesor të shkruar, të dorëzuar në komitetin përkatës nga ana e drejtorisë së linjës ose nga institucionet dhe shoqatat e ndryshme, do të bëhet në pajtim me rendin si vijon:

- 1) propozuesi i projekt - aktit të përgjithshëm ose propozimit tjetër përbajtjesor do të flasë i pari;
- 2) në rast se propozuesi nuk është anëtar i komitetit, drejtori i drejtorisë së linjës do të ketë të drejtë të flasë i dyti dhe kryesuesi i treti dhe anëtarët e tjerë sipas radhës dhe zyrtarët profesional të drejtorive të linjës;
- 3) në fund të debatit, propozuesi i projekt-aktit të përgjithshëm ose i propozimit tjetër përbajtjesor, do të ketë të drejtë të përgjigjet dhe të bëjë komente dhe pastaj kryesuesi i komitetit përkatës përmbyll debatin (shqyrtimin).

#### Neni 17

Një anëtar i komitetit mund të flasë vetëm një herë gjatë rrjedhës së një debati, për një pikë të rendit të ditës, me qëllim të qartësimit dhe të sqarimeve apo të dhënies së përgjigjeve do të ketë të drejtën edhe njëherë të diskutoj. Fjalimet e anëtarëve të komitetit dhe të drejtorit të linjës, zgjasin më së shumti pesë (5) minuta. Personat tjerë në komitet mund të flasin më së shumti tre (3) minuta.

#### Neni 18

18.1. Kryesuesi i komitetit duhet të kujdeset që ta mbaj rendin në komitet. Anëtarë i komitetit, zyrtarët dhe personat tjerë janë të detyruar t'i respektojnë rregullat e punës në komitet dhe t'i zbatojnë urdhrat eventuale të kryesuesit të komitetit.

18.2. Kryesuesi i komitetit përkatës mund të urdhërojë një anëtar ose zyrtari tjetër, i cili sipas mendimit të tij veprimet e tij ose saj janë në kundërshtim me kodin e sjelljes që t'i përbahet rregullave të punës në komitet.

18.3. Anëtarëve të komiteteve ju ndalohet pirja e duhanit dhe përdorimi i celularëve në mbledhje.

## Neni 19

19.1. Në rast të ndonjë parregullsie serioze që paraqitet në komitet, kryesuesi komitetit mund ta shtyj mbledhjen në tërësi ose mund ta pezullojë atë për një kohë të caktuar dhe e njofton kryesuesin e Kuvendit të Komunës.

19.2. Në rast se në mbledhjet e komiteteve marrin pjesë zyrtarët e organeve ose institucioneve tjera, personat tjerë dhe përfaqësuesit e shtypit, duhet të respektojnë kodin e mirësjelljes, nëse nuk ka rregulla tjera të sjelljes përkitazi me pjesëmarrjen dhe sjelljen e zyrtarëve të organeve ose institucioneve tjera, për persona tjerë dhe përfaqësues të shtypit që ndjekin mbledhjet e komitetit.

19.3. Kryesuesi komitetit kërkon nga të gjithë personat që t'i respektojnë rregullat e tillë, e në rast se nuk i respektojnë të largohen nga mbledhja.

## Përcaktimi i rendit të ditës

### Neni 20

20.1. Kryesuesi i komitetit përkatës në bashkëveprim me strukturat relevante dhe drejtoritë e linjës, propozon rendin e ditës për mbledhje.

20.2. Kryesuesi i komitetit do të kujdeset që në rendin e ditës të jenë çështjet me prioritet të përcaktuara nga ana e drejtorisë së linjës dhe organeve tjera të komunës, posaçërisht kuvendit të komunës.

20.3. Anëtarët e komitetit mund të miratojnë rendin e propozuar ose të kërkojnë modifikimin e tij, duke bërë propozimin konkretë, por që nuk është në kundërshtim me përgjegjësit e komitetit përkatës.

20.4. Për çështjet e rendit të ditës për të cilat nuk mund të arrihet pajtimi mund të bartën në mbledhjen e ardhshme të komitetit, kurse kryesuesi ndërkohë duhet të zhvillojë konsultime për të arritur pajtime për çështjen e bartur.

## Çështjet e ngutshme

### Neni 21

21.1. Në të gjitha mbledhjet e komitetit, çdo anëtarë që paraprakisht e ka marrë lejen kryesuesit të komitetit, mund të propozojë që komiteti menjëherë të marrë parasysh një çështje të ngutshme më interes të veçantë publik, e cila është paraqitur në kohën midis dy mbledhjeve të komitetit. Nëse kryesuesi së bashku me anëtarët e komitetit, konsideron se çështja meriton vëmendjen e menjëherështme të komitetit, ai do të lejojë anëtarin në fjalë që t'i arsyetojë propozimin e tij në komitet, dhe pastaj do të vë në votim atë çështje.

21.2. Përjashtimisht kur propozimi i bërë nuk është bërë nga një anëtar i komitetit, atëherë drejtorit të drejtorisë së linjës do t'i lejohet të paraqes pikëpamjet e veta, para se të votohet. Nëse komiteti vendos të marrë parasysh çështjen, atëherë duhet ta bëjë një gjë të tillë gjatë takimit, ndërsa orari i punës duhet të përshtatet sipas kësaj.

## Votimi

### Neni 22

22.1. Komitetet nuk janë organe vendimmarrëse brenda komunës. Për çështjet e shqyrtaura bëjnë rekomandime në KPF dhe në Kuvendin e Komunës, duke dhënë arsyetimë përkatëse.

22.2. Nëse komiteti për çështje të caktuara duhet të votojë për rekomandimin përkatës, vendimi duhet të merret me konsensus të të gjithë anëtarëve të komitetit, mirëpo nëse kjo nuk mund të arrihet, vendimet merren me votimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm.

22.3. Votimi bëhet sipas mënyrës "për" – "kundër" – "abstenim" me ngritje dore. Në rast të numrit të barabartë të votave të hedhura "për" dhe "kundër" ndonjë propozimi, kryesuesi e ka një votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave.

### Ndihma teknike për komitete Neni 23

Drejtoria për Administratë, përkatësisht shërbimi i Kuvendit të Komunës, do të ofrojë mbështetje të nevojshme logjistike dhe administrative për sigurimin e kushteve të nevojshme për mbajtjen e mbledhjeve të komiteteve, duke përfshirë shpërndarjen e materialeve për mbledhje, vendtakimet, procesmbajtësin, vendosjen procesverbaleve në dosje dhe të materialeve të tjera të komiteteve.

### Gjuhët e përdorura në komitete Neni 24

Mbledhjet e komitetit mbahen në gjuhët zyrtare, duke siguruar përkthimin adekuat sipas nevojës. Të gjitha dokumentet zyrtare të komitetit shkruhen në gjuhët zyrtare.

### Ndryshimi i rregullores së punës së Komiteteve Neni 25

25.1. Kryesuesi i komitetit, e shqyrton vazhdimi i rregulloren e punës dhe kohë pas kohe mund t'i propozojë Kuvendit ndryshime, me arsyetim përkatës. Me propozimin për ndryshimin e kësaj rregulloreje, duhet të njoftohen edhe komitetet tjera, para se Kuvendi të marrë vendim për ndryshimin apo plotësimin e kësaj rregulloreje.

25.2. Propozimin për ndryshimin e rregullores sipas paragrafit 25.1 të kësaj rregulloreje, mund ta paraqesë edhe anëtarë i komitetit përkatës, mbështetur nga së paku 1/3 e anëtarëve të tjerë. Vendimin përfundimtar për ndryshimin e rregullores e merr Kuvendi i Komunës.

### Dispozitat kalimtare dhe të fundit Neni 26

26.1. Çdo dispozitë e kësaj rregulloreje që është në kundërshtim me LVQL-në dhe Statutin e Komunës, nuk do të zbatohet.

### Neni 27

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në Web faqen.

Viti, Prill 2018

Kryesuesi i Kuvendit  
Naim PTRA

